

Përktheu në Shqip: **Elmedina Çesko**

DASHURIA SI MJEKËSI E MISHËRUAR

C. Sue Carter

Drejtoreshë në Institutin Kinsey

Abstrakti

Si një specie e ndjeshme, njerëzit janë në prag të gjetjeve të reja drejt origjinës së obsesionit madhështor që ne e quajmë "dashuri". Është vërtetuar se marrëdhëniet e shëndetshme mund të mbrojnë nga sëmundjet dhe të rikthejnë trupin në gjendjen e mëparshme gjatë përballjes me sëmundjen. Pa marrëdhënie pozitive, sidomos në jetesën e hershme, njerëzit nuk arrijnë të lulëzojnë, edhe nëse plotësohen të gjitha nevojat e tyre bazike biologjike. "Humbja e dashurisë" është një nga format më të fuqishme të stresit dhe traumës.

Megjithatë, mekanizmat përmes të cilave dashuria mbron dhe shëron, tani po bëhen të dukshme. Dashuria kuptohet më lehtë nëpërmjet pikëvështrimeve të së kaluarës evolucionare dhe në dritën e fiziologjisë sonë bashkëkohore. Në epiqendrën e kësaj historie është një hormon gjitar, që është oksitocina dhe një molekulë edhe më e lashtë, e njohur si vazopresina. Këto blloqe ndërtimi biokimike të dashurisë nuk janë unike për njerëzit dhe ndahen me lloje tjera të shumta shoqërore. Përmes studimit të sjelljes sociale tek gjitarët tjerë, ne mësojmë gjithashtu se e njëjta fiziologji që qëndron pas fuqisë shëruese të dashurisë, zvogëlon inflamacionin, rregullon sistemin nervor autonom, sistemin imunitar dhe madje rregullon mikrobiomin. Për më tepër, sistemi oksitocin-vazopresin rregullohet nga përvoja gjatë gjithë jetës, duke ndihmuar në shpjegimin e pasojave të qëndrueshme fizike të dashurisë dhe vështirësisë. Duke shqyrtuar biologjinë e lidhjeve shoqërore dhe prindërimin, ne po zbulojmë rrugët që i lejojnë njerëzit të përjetojnë dhe të mishërojnë dashurinë.

Fjalë kyçe: Oksitocina, dashuria, monogamia, rripta.

Përktheu në Shqip: **Elmedina Çesko**

**Progresi drejt një kuptimi më të madh të shkencës dhe hulumtimit brenda
Psikoterapisë Trupore: Pjesa 1**

INTERNATIONAL BODY PSYCHOTHERAPY JOURNAL

THE ART AND SCIENCE OF SOMATIC PRAXIS



Courtenay Young & Herbert Grassmann

Abstrakti

Ky artikull tre pjesësh shqyrton:

Pjesa 1: Historinë e iniciativave të Komitetit të Shkencor dhe Hulumtues të EABP'së

Pjesa 2: Llojet e ndryshme të hulumtimeve të duhura për Psikoterapinë Trupore

Pjesa 3: Mundësitë për zhvillimet e më tutjeshme drejt një kulture më të avancuar kërkimore në Psikoterapinë Trupore.

Hulumtimi mbi efikasitetin dhe efektivitetin e shumë mënyrave të ndryshme të psikoterapisë është thelbësore nëse kjo degë (apo 'rrjedhojë') e psikoterapisë është që të ketë ndonjë qëndrim në gjithë komunitetin e përgjithshëm të psikoterapisë, me universitetet, me qeveritë dhe ministritë e shëndetësisë, apo edhe me publikun e gjerë. Deri në kohët e fundit, fusha e Psikoterapisë Trupore ka qenë një teori mjaft e fuqishme; gjithashtu ka qenë mjaft e mirë (deri kohët e fundit) në praktikën klinike me modalitetet dhe metodat e saj të shumta; por ka qenë e në lidhje të dobët me hulumtimet relevante. Në këtë artikull, shqyrtohen aspekte të ndryshme të hulumtimit të Psikoterapisë Trupore. Hulumtimi në fushën e Psikoterapisë Trupore shihet si një pjesë thelbësore e zhvillimit të një kulture profesionale, e cila duhet të nxitet si në trajnime ashtu edhe në praktikë. Gjithashtu është e nevojshme lidhjet me departamentet e hulumtimeve në universitete. Prandaj, pavarësisht se janë të trajnuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të jenë në gjendje (shpresojmë) të demonstrojnë kompetencat profesionale e një psikoterapist trupor, si një 'klinikist', ekziston një rol shtesë (apo grup i kompetencave) - si një potencial hulumtues -mjek - që tani duhet të zhvillohen dhe të nxiten, veçanërisht pasi ka perceptime shpesh negative aspektin e hulumtimeve - ose shërbimeve boshe – të paguara për nevoja hulumtuese - të gjenden brenda komunitetit të përgjithshme të psikoterapisë, dhe veçanërisht brenda psikoterapisë humaniste dhe trupore (somatike). Disa nga shqyrtime më të gjera dhe nga zhvillimet e fundit në lidhje me hulumtimet për Psikoterapinë Trupore janë të cekura, por ky artikull përqendrohet më tepër në zhvillimin e një kulture të qëndrueshme 'hulumtues -praktikues' në Psikoterapinë Trupore, në kohën e tanishme dhe sidomos për atë të ardhmen.

Fjalët kyqe: Hulumtime në Psikoterapinë Trupore, Hulumtime Relevante në Psikoterapinë Trupore, Bazuar në Evidencë, Hulumtime Bazuar në Praktues, Modul i Trajnimit Hulumtues, Praktiues, Lidhjet Hulumtuese, Studim Rasti.

Përktheu në Shqip: **Elmedina Çesko**

Praktikimi dhe Hulumtimi i Psikoterapisë Trupore Një sondazh i praktikuesve të psikoterapisë trupore

Biljana Jokić, Frank Röhrich dhe Courtenay Young

Abstrakti

Praktika dhe hulumtimi i psikoterapisë duhet të plotësojë njëra-tjetrën; megjithatë, lidhjet midis tyre janë pak të zhvilluara. Ky studim është hartuar dhe zhvilluar me qëllim të mbledhjes së informatave rreth praktikës së psikoterapisë trupore (BP) dhe burimeve kërkimore në mes të psikoterapistëve trupor. Në total prej 404 psikoterapist trupor nga gjithësej 36 shtete morën pjesë në një anketim online.

Gjetjet zbuluan një larmi të madhe të modaliteteve të BP-së që aktualisht praktikohen brenda dhe anëmbanë vendeve të ndryshme, veçanërisht diversiteti në lidhje me karakteristikat socio-demografike të psikoterapeutëve trupor: 66.4% e pjesëmarrësve ishin mbi 50 vjeç, në sygjerimin e një mungesë të të rinjve të përfshirë në praktikimin dhe hulumtimin e BP'së. Shumica e terapistëve ofrojnë PB për të rriturit dhe kryesisht në formatin e seancave individuale në praktikën private, ndërsa vetëm disa praktikues të BP-së punojnë në repartet kryesore të kujdesit shëndetësor. Rezultatet gjithashtu kanë konstatuar se ekziston njohuri të konsiderueshme hulumtuese, përvojë dhe interes në hulumtim në mesin e praktikuesve BP'së, por ekziston mungesë në zbatimin e këtyre burimeve të kërkimit në psikoterapinë trupore. Rezultatet shqyrtohen me theks të veçant mbi implikimet praktike: në rolin e shkollave të trajnimit të BP'së për të rritur kulturën e kërkimit midis praktikuesve; rëndësia e shkëmbimit të përvojave dhe hulumtimeve të BP'së në mes të vendeve (dhe gjuhëve) të ndryshme; dhe nevojës për të zhvilluar bashkëpunime ndërmjet praktikuesve dhe grupeve akademike me qëllim të forcimit të kapaciteteve hulumtuese dhe për të grumbulluar njohuri rreth konstruktimit intrigues të mishërimit të aplikuar në BP.

Fjalët kyçe: psikoterapia trupore, praktika profesionale, psikoterapia e mbështetur empirikisht, anketa, psikoterapistët

Përktheu në Shqip: **Elmedina Çesko**

**Rreth studimit të rasteve
& Studimet e rasteve në Psikoterapinë Trupore
(apo mungesa e tyre)**

INTERNATIONAL BODY PSYCHOTHERAPY JOURNAL

THE ART AND SCIENCE OF SOMATIC PRAXIS



Një prezantim në Simpoziumin Shkencor të Kongresit të EABP'së në vitin 2018

Courtenay Young

Abstrakti

Ky është pjesë e një prezantimi në Simpoziumin Shkencor në Kongresin EABP'së të vitit 2018 në Athinë. Ajo u shoqërua nga një numër të slideve, të cilat mund të arrihen nga faqja e internetit të EABP'së.

Fjalët kyçe: psikoterapia trupore, studim rastesh

Përktheu në Shqip: **Elmedina Çesko**

Hyrje në hulumtimin cilësor dhe teorinë e bazuar

Christina Bader Johansson

Abstrakti

Në këtë artikull janë paraqitur konceptet e praktikuesit reflektues, praktikat e bazuara në prova dhe mënyra e ndryshme e të bërit hulumtime kualitative. Duke i bërë pyetjet të cilat fillojnë me "çfarë" dhe "si", hulumtimi kualitativ kërkon cilësinë specifike që është tipike për një fenomen. Një nga metodat më të zakonshme sot në hulumtimin kualitativ është Teoria e Tokëzimit. Një model i "njësive që bartin kuptimin" bëhet e dukshme midis të gjitha vëzhgimeve ose përgjigjeve për pyetjet e hapura, të cilat pastaj kodohen në kategori. Ky proces kodimi është e përshkrur; ajo quhet një krahasim i vazhdueshëm derisa të arrihet përmbushja e një teme, e cila kristalizon kuptimin qendror të një fenomeni. Janë paraqitur disa standarde të dobishme të temave për vlefshmërinë dhe besueshmërinë në hulumtimin kualitativ.

Fjalët kyçe: hulumtimi kualitativ, Teoria e Tokëzimit, krahasimi i vazhdueshëm, përmbushje

INTERNATIONAL BODY PSYCHOTHERAPY JOURNAL

THE ART AND SCIENCE OF SOMATIC PRAXIS



Përktheu në Shqip: **Arber Zeka**

Zhvillimi i një Hulumtimi Kërkimorë Mendja në Praktikën e Psikoterapisë Trupore

Prezantim në Kongresin e EABP-së 2018

Simpoziumi i Komitetit të Shkencës dhe Hulumtimeve (SRC)

Zoe Schillat

Abstrakti

Prezantimi i mëposhtëm i referohet aspekteve të marrëdhënies dhe ndërveprimit ndërmjet hulumtimit dhe praktikës klinike në Psikoterapinë Trupore (BPT), siç janë përshkruar në literaturën përkatëse dhe të subjektet e studimeve të rasteve, si një fushë ku hulumtimi, si dhe mendja klinike mund të mësohen dhe të zhvillohen. Gjithashtu, kjo i referohet një aktiviteti "në punë në vazhdimësi" të organizuar nga Komiteti Shkencor i Shoqatës Greke për Psikoterapi Trupore (PESOPS), e fokusuar në informimin dhe inkurajimin e anëtarëve lidhur me shkrimin dhe botimin e rasteve studimore.

***Fjalët kyçe:** Hulumtimi dhe Praktika Klinike në BPT, Studimet e rasteve dhe Udhëzimet EABP-së, Zhvillimi i Hulumtimeve të Mendjes, Aktiviteti për Punë në Progres.*

Aktivitetet e Psikoterapisë Trupore në Turqi

Celâl Eldeniz

Përktheu në Shqip: **Arber Zeka**

Abstrakt

Psikoterapia Trupore është një metodë mjaft e re psikoterapeutike në Turqi. Ekzistojnë botime turke të disa librave nga Reich dhe Lowen, trajnimet kanë filluar këto viteve të fundit - këto dhjetë vjet. Megjithatë, në Turqi nuk ka psikoterapeutë të certifikuar nga psikoterapia trupore. Nga ana tjetër mungesa e një asociacioni kombëtar të psikoterapisë në Turqi nxit nevojën e një shoqate të psikoterapisë trupore për të monitoruar dhe rregulluar proceset e trajnimit dhe certifikimit të psikoterapistëve trupore të ardhshëm në Turqi. Prandaj, së shpejti do të bëhet krijimi i një Asociacioni të Psikoterapisë Trupore, i cili gjithashtu do të punojë drejt krijimit të një komuniteti aktiv të Psikoterapisë Trupore në Turqi.

Fjalët kyçe: Psikoterapia Trupore, Trajnimet, Fillimi i Shoqatës së Psikoterapisë, Turqi.

INTERNATIONAL BODY PSYCHOTHERAPY JOURNAL

THE ART AND SCIENCE OF SOMATIC PRAXIS



Shqyrtime në Linje (Webinar):

1. A jemi gati për të ardhmen e "homo neuroticus" dhe si do të ndryshojë psikoterapia?

Mariana Todorova

Abstrakt

Inteligjenca artificiale (AI), njerëzit si një algoritëm biologjik, realitet virtual, më shumë se 2 prindër, hologramë kundrejt njerëzve, zgjerimi i vazhdueshmërisë së jetës, ilaç i plotë ... se si këto tendenca me të cilat përballemi do të formësojnë njerëzit dhe emocionet, jetët njerëzore, realitetin e tyre profesionin tonë si psikoterapeutë.

Fjalë kyçe: fitim, komunitet, ndarje, teknologji, digjitalizim, psikoterapi trupore, realitet virtual dhe të përzier.

2. Format e reja të subjektivitetit ndërmjet identitetit dhe dissociimit

Maurizio Stupiggia

Abstrakt

Ne jemi dialog: i personit me veten, dhe me persona të tjerë. Çrregullimi mendor është ndërprerja e këtij dialogu përmes të cilit përpiqemi të ndërtojmë dhe ruajmë identitetin tonë personal dhe pozitën tonë në botë. Kriza e dialogut të personit me ndryshimin që e banon dhe me ndryshimin e mishëruar në personat e tjerë, është në zemër të çrregullimeve mendore.

Unë dua të reflektoj në lidhje me Vete dhe të Tjerët, gjatë një kohe të rritur kushtet disociuese të jetës sonë. Ne po jetojmë një ndjenjë në rritje të vetmisë, të izolimit social dhe emocional, që lidhet me një nivel në rritje alarmi, si individ, ashtu edhe si komunitet.

Fjalët kyçe: forma të subjektivitetit, identiteti, dissociimi, realiteti virtual dhe i përzier, siguria, marrëdhënia, dialogu, pauzë, organizimi i brendshëm